

## Specifikime Teknike

**LOT III- Rikualifikimi i Pazarit te Ri (Markata e Mish-Peshkut, restaurimi i 4 objekteve dhe rikonstruksioni i fasadave perreth sheshit Avni Rustemi dhe paisjet)**

*Restaurimi i 4 Objekteve*



## **Punime prishje – R.1.1**

### **R.1.1.1 - Heqje pllakash mermeri trashësi 3cm (sipërfaqe murature e veshur deri në lartësinë 170 cm nga dyshemeja)**

Pjesa e muraturës së katin përdhe është e veshur me pllaka mermeri me spesor 2.5-3 cm. Kjo veshje që arrin deri në lartësinë 1.7 m nga dyshemeja, do të hiqet dhe sipërfaqja e muraturës do të suvatohet. Heqja e pllakave do të bëhet me daltë e çekiçduke u kujdesur që goditjet të mos shkojnë deri në sipërfaqen e muraturës për të mos e dëmtuar materialin e tullës.

Është përllogaritur që një m<sup>2</sup> sipërfaqe e veshur me pllakë mermeri të zhvishet nga një punëtor për rreth 1.5 orë.

### **R.1.1.2 - Heqje/cmontim tendash me konstruksion metalik**

Këta elementë janë të montuar në katin përdhe, si tenda për të mbrojtur nga dielli vetratat e dyqaneve. Heqja e tyre do të bëhet me trapano për të zhvidhosur vidhat me të cilat është fiksuar nëmur konstruksioni metalik I tyre.

Është përllogaritur qënjë tendë e tillë të hiqetbrenda maksimumi 1 orë.

### **R.1.1.3 - Heqje/cmontim reklamash me konstruksion metalik**

Gjithashtu edhe këta elementë janë të instaluar në katin përdhe. Janë reklama të thjeshta, të pa ndriçuara dhe pa lidhje elektrike. Për çmontimin e reklamave do të veprohet njësoj si për çmontimin e tendave; do të zhvidhosen me trapano vidhat e fiksimit të konstruksionit metalik.

Është përllogaritur që një reklamë e tillë të çmontohen brenda maksimumi 1 orë.

### **R.1.1.4 - Heqje grila druri (dyer ballkoni dhe dritare)**

Dyert dhe dritaret e drurit janë aktualisht të vendosura në dritaret dhe dyert e ballkoneve në katin e parë, të dytë dhe të tretë. Këto janë grilat e vendosura në objekt që në kohën e ndërtimit të objektit. Gjendja e tyre është tej mase e degraduar aq sa nuk mund të ruhen ose të restaurohen. Për shkak të mungesës së mirëmbajtjes në vite si dhe kontaktit të tyre të përhershëm me agjentët atmosferikë, gjendja e tyre paraqitet e degraduar tërësisht: mungojnë elementë, në disa raste materiali është

bymyer dhe bëhet e pa mundur hapja ose mbyllja e tyre, ndonjëherë edhe lëvizja. Heqja e tyre nga vendi do të bëhet manualisht, duke çmontuar menteshat që I mbajnë grilat të lidhura në muraturë. Çmontimi i një grille është përlogaritur të realizohet në një kohëjo më të gjatë se 1orë.

#### **R.1.1.5 - Heqje kasa druri (dyer ballkoni dhe dritare)**

Dyert dhe dritaret e drurit janë aktualisht të vendosura në dritaret dhe dyert e ballkoneve në katin e parë, të dytë dhe të tretë. Këto janë dritaret dhe dyert e vendosura në objekt që në kohën e ndërtimit të objektit. Gjendja e tyre është tej mase e degraduar aq sa nuk mund të ruhen ose të restaurohen. Heqja e tyre nga vendi do të bëhet manualisht, duke çmontuar menteshat që I mbajnë dritart/dyert të lidhura në muraturë.

Çmontimi i një dritare/dere është përlogaritur të realizohet në një kohëjo më të gjatë se 1 orë.

#### **R.1.1.6 - Heqje vetrata duralumin**

Vetratat e d/aluminit janë në njësitë tregëtare në katin përdhe. Këto janë të montuara në faqet e kolonave dhe harqeve të harkadës. Për këtë arsye duhet të tregohet kujdes gjatëçmontimit për të mos dëmtuar muraturën.

Çmontimi i vetratave të një hapësire drite midis dy kolonave është përlogaritur të realizohet në jo më shumë se 1 orë.

#### **R.1.1.7 - Heqje elemente metalike nga fasada e objektit (zgara lulesh, elemente për kapjen e telave të rrobave, etj.)**

Këta elementë janë të vendosur nëobjekt nga përdoruesit e objektit gjatë gjithë viteve të përdorimit. Kryesisht këta elementë janë present në katin e parë, të dytë dhe të tretë dhe më pak në katin përdhe. Një pjesë e mirë e elementëve të huaj janë të vendosur dhunshëm mbi elementët e dekorit. Për këtë arsye heqja e tyre duhet të bëhet me kujdes për të mos I dëmtuar më tej elementët e dekorit ose vetë muraturën.

Heqja e këtyre elementëve është përlogaritur të bëhet në një kohë shumë të shkurtër. Heqja e të gjithë elementëve metalikë në fasadë të mos zgjasë më shumë se 3-3.5 orë.

#### **R.1.1.8 - Çmontim kondicionerësh në fasadë**

Janë gjithsej dy kondicionerë të vendosur në fasadat e katit përdhe të objektit.

Çmontimi I një kondicioneri është përlogaritur të zgjasëjo më shumë se 1.5 orë.

#### **R.1.1.9 - Çmontim ndriçuesish në fasadë**

Janë gjithsej 7 ndriçues që duhen çmontuar, të vendosur në një lartësi lehtësisht të arritshme pa qenë nevoja për shkallë apo skelë.

Çmontimi I një ndriçuesi është përllogaritur të zgjasëjo më shumë se 15 min.

*Shënim 1/1.1 - Zërat e mësipërm të punës (R.1.1.1 – R.1.1.9) janë proceset e para nga të cilët do të nisë puna për zbatimin e projektit, gjithashtu mund të zhvillohen të gjithë njëkohësisht.*

#### **R.1.1.10 – Prishje muraturë tulle**

Bëhet fjalë për murin I cili është ndërtuar në katin përdhe për të mbyllur harqet midis tre kolonave veriore. Ky proces do të bëhet duke treguar kujdes për të mos dëmtuar muraturën origjinale të objektit.

Prishja e muraturës së tullës është përllogaritur të zgjasë 6.2/ m<sup>3</sup> duke përfshirë edhe largimin e inerteve dhe pastrimin e vendit.

#### **R.1.1.11 – Prishje suva ekzistuese**

Ky process do të zhvillohet në të gjithë sipërfaqen e të katërtave fasadave të objektit. Heqja e suvasë do të bëhet me matrapik me daltënë formë spatule. Gotitjet e matrapikut nuk duhen bërë në drejtimin pingul me sipërfaqen e suvasë sepse nga goditja e fortë mund të dëmtojë muraturën e tullës nën suva.

Prishja e një m<sup>2</sup> suva është përllogaritur të realizohet në jo më shumë se 1.5 orë duke marrë parasysh që suvaja është me llaçimento dhe që duhet treguar kujdes gjatë prishjes për të mos dëmtuar muraturën.

#### **R.1.1.12 - Heqje mareriali të degraduar në dekore dhe parapete (pastrim mekanik me spatul dhe furçë teli)**

Ky proces do të realizohet mekanikisht fillimisht duke goditur lehtësisht me spatul mbi pjesën e degraduar të dekoreve për të hequr materialin e degraduar por njëkohëshit edhe për të identifikuar kufirin deri ku ka material të degraduar. Më pas pas bëhet pastrimi me furçë të butë teli për të hequr edhe pjesët më të imëta të materialit të degraduar.

Ky proces është përllogaritur të zgjasë jo më shumë se 2 orë për ml material të degraduar në dekoret e dyerve dhe dritareve, dhe ndoshta pak me gjatë për materialin e degraduar të dekoreve horizontale në

nivelin e dyshemesë së katit të parë, dyshemesë së katit të dytë si dhe atij të nivelin e poshtëm tëçatisë.

*Shënim 1/1.2 - Zërat e mësipërm të punës (R.1.1.10 – R.1.1.12) janë proçese të cilët mund të zhvillohen të gjithë njëkohësisht.*

#### **R.1.1.13 – Çmontim I mbulesës sëçatisë me tjegulla marsejeze**

Ky proçes duhet të realizohet me kujdes që të mos dëmtohen tjegullat; të ruhen sa më shumë prej tyre për t'u ripërdorur për mbulimin e çatisë në përfundim të punimeve.

Çmontimi I një metri katror mbulesëçatie me tjegulla marsejeze është përlllogaritur të zgjasëjo më shumë se 2.5 orë, duke marrë parasysh faktin qëështë e pa njohur gjendja e konservimit të kosntruksionit tëçatisë.

#### **R.1.1.14 – Çmontim konstruksion çati vendi**

Gjatë realizimit të këtij proçesi do të bëhet edhe seleskionimi I elementëve që mund të ripërdoren në ndërtimin e çatisë së re.

*Shënim 1/1.3 – Zërat e punës R.1.1.13 dhe R.1.1.14 jo pa qëllim janë vendosur të fundit në grupin e punimeve të prishjes. Qëllimi është që objekti të qëndrojës më pak kohë I zbuluar. Prandaj janëdy punimet fundit të prishjes dhe dy të parët në grupin e punimeve të ndërtimit.*

### **Punime ndërtimi – R.1.2**

#### **R.1.2.1 - Ndërtim çati vendi HD~8m mbuluar me tjegulla marsejeze**

Pas procesit të hapjes së objektit do të vlerësohet gjendja faktike e elementëve që do të shërbejnë për t'u ripërdorur dhe elementët që do të zëvendësohen. Elementët që nuk paraqesin anomali (deformim, kalbje apo dëmtim nga insektet) do të ripërdoren. Elementët e tjerë që nuk do të përdoren do të ruhen në magazinë për ti pasur si referencë për prodhimin e materialit tëri. Elementët drusorë që do të zëvendësohen duhet të jenë dru pishe, minimalisht 5 vjet i stazhionuar në mënyrë natyrale dhe i trajtuar me dy duar vaj lini dhe insekticid. Elementët që do të zëvendësohen duhet të bëhen me të dhënat saktësisht si elementët ekzistues. (lloj druri, dimensione dhe teknikë).

Çatia aktuale nuk ka shtresën e dyshemesë së drurit si dhe shtresat termo dhe hidro izoluese. Çatia e re parashikon ndërtimin e saj me të gjithë elementët konstruktivë dhe izolues të nevojshëm. Materiali drusor I shtrësës së dyshemesë sëçatisë do të jetë dru pishe I stazhionuar në mënyrë nëtyrale, minimalisht 5 vjet dhe I trajtuar me vaj lini dhe insekticid.

#### **R.1.2.2 - Hidroizolim me emulsion bitumi dhe dy shtresa katrama**

Ky zëeshtë element krejtësisht I ri në çatinë e objektit. Aktualisht çatia nuk ka një shtresë hidroizoluese. Hidroizolimi do të bëhet duke I mbivendosur shtresat (rreth 12-15 cm). Në pjesët fundore, perimetralisht çatisë, shtresa hidroizoluese do të zgjatet edhe mbi kornizën horizontale tëçatisë.

*Shënim 1/2.1 – Sikurse u cilësua edhe në paragrafin e punimeve të prishjes, ndërtimi I çatisë së re është procesi I parë ndër punimet e ndërtimit në mënyrë që të sigurohet objekti si dhe mbarëvajtja e punimeve në vijim.*

#### **R.1.2.3- Suvatim muri I jashtëm me llaç gëlqere 1:3**

Në objekt aktualisht suvaja ka edhe përmbajtje çimentoje. Pas përpjekjes së pasukseshme për të bërë analiza laboratorike për të gjetur raportin e përzjerjes së përbërësve të llaçit ekzistues, gjykojme që suvaja e re të jetë vetem me llaç gëlqere në raportin 1:3 ku gëlqerja të jetë e stazhionuar minimalisht 1 vit. Ky lloj llaçi është miqësor ndaj materialit të muraturës, është më i butë së materiali dhe lejon aspirimin si dhe largimin e lagështirës. Duke përdorur këtë lloj llaçi jemi të sigurtëqë muratura nuk do të ketë dëmtime afatgjata ose afatshkurtra që vijnë për shkak të suvasë.

#### **R.1.2.4- Hidroizolim me dy shtresa mapei solete ballkoni dhe mure ballkoni deri ne lartesine 70 cm nga dyshemeja.**

Ky proces do të aplikohet në murin e objektit, në zonat e ballkoneve ku për shkak të mos disiplinimit të ujërave të shiut, lagështira është ngjitur në faqen e murit duke e dëmtuar materialin në elementët dekorativë. Shtresat e hidroizolimit do të aplikohen pas dhënies së dorës së parë të suvatimit. Pas aplikimit të shtresës hidroizoluese, aplikohet edhe shtresa e dytë e suvasë.

#### **R.1.2.5 - Plotësim elementesh dekorativë dhe parapete me llaççimento**

Fillimisht bëhet përgatitja e kallëpëve për çdo profil të veçantë dekori, nëpërmjet të cilëve më pas do të bëhet e mundur plotësimi në vend I elementëve të degraduar. Për plotësimin e elementëve të dekoreve do të përdoret llaç gëlqere dhe çimento. Në rastin e dekoreve, përdorimi I çimentos është I përshtatshëm duke qenë se elementët e dekorit janë më të ekspozuar se suvaja në përgjithësi si ndaj

dëmtimeve që vijnë për shkaqe natyrore (agjentët atmosferikë) si ndaj dëmtimeve mekanike. Raporti I çimentos, gëlqeres dhe rërës nuk duhet të jetë më I dobët se respektivisht 1:3:12 sepse ndryshe gëlqerja do të ulë rezistencën e llaçit ndaj ngricave. Megjithatë raporti nuk duhet të jetë as më I fortë se 1:2:9 sepse kjo është një përbërje e papërshtatëshme për objektet e trashëgimisë.

#### **R.1.2.6 - FV dritare druri pishë të stazhionuar**

Ky zë I referohet furnizimit dhe vendosjes në vepër të dritareve në katin e parë, të dytë dhe të tretë. Të gjitha kasat dhe kanatat e dritareve duhet të realizohen me dru pishë të stazhionuar në mënyrë natyrore për një periudhë minimalisht 5 vjeçare dhe të jetë trajtuar me dy duar vaj lini përpara se të montohet në vepër.

Karakteristikat e drurit të pishës duhet të jenë si më poshtë:

- \* Lagështira jo më e lartë se 7%
- \* Pesha volumore rreth 450-540kg/m<sup>3</sup>
- \* Kufiri I rezistencës në tërheqje rreth 130MPa.

Kujdes I veçantë duhet të tregohet gjatë vendosjes së tyre në vepër, për përuithjen sa më të mirë të me hapësirat përkatëse.

#### **R.1.2.7 - FV dyer druri pishë të stazhionuar**

Ky zë I referohet furnizimit dhe vendosjes në vepër të dyerve të ballkoneve në katin e parë, të dytë dhe të tretë. Të gjitha kasat dhe kanatat e dyerve duhet të realizohen me dru pishë të stazhionuar në mënyrë natyrore për një periudhë minimalisht 5 vjeçare dhe të jetë trajtuar me dy duar vaj lini përpara se të montohet në vepër. Dyert e ballkoneve kanë të njëjtin konfiguracion njësoj si dritaret prandaj është përdorur si referencë edhe çmimi I zërit R.1.2.6.

Karakteristikat e drurit të pishës duhet të jenë si më poshtë:

- \* Lagështira jo më e lartë se 7%
- \* Pesha volumore rreth 450-540kg/m<sup>3</sup>
- \* Kufiri I rezistencës në tërheqje rreth 130MPa.

Kujdes I veçantë duhet të tregohet gjatë vendosjes së tyre në vepër, për përuithjen sa më të mirë të me hapësirat përkatëse.

#### **R.1.2.8 - FV grila druri pishë të stazhionuar**



Ky zë I referohet furnizimit dhe vendosjes në vepër të grilave të drurit nëpër dritaret dhe dyert e ballkoneve në katin e parë, të dytë dhe të tretë. Të gjitha grilat duhet të realizohen me dru pishe të stazhionuar në mënyrë natyrale për një periudhë minimalisht 5 vjeçare dhe të jetë trajtuar me dy duar vaj lini përpara se të montohet në vepër.

Karakteristikat e drurit të pishës duhet të jenë si më poshtë:

- \* Lagështira jo më e lartë se 7%
- \* Pesha volumore rreth 450-540kg/m<sup>3</sup>
- \* Kufiri I rezistencës në tërheqje rreth 130MPa.

Kujdes I veçantë duhet të tregohet gjatë vendosjes së tyre në vepër, për përuthjen sa më të mirë të me hapësirat përkatëse.

#### **R.1.2.9 - FV sipërfaqe masive xhami. Xham triplex me kasë duralumini**

Ky zë pune I referohet furnizimit dhe vendosjes së vetratave në katin përdhe në hapësirën midis kolonave. Vetrata do të realizohet me xham 10 mm triplex, “guardian extra clear”. Korniza do të jetë prej material d/alumini por do të montohet në faqen e brendëshme të kolonave në mënyrë që nga jashtë kjo kornizë të jetë tërësisht e palexueshme. Është përzgjedhur kjo lloj vetrate për të mundësuar perceptimin në vijimësi të harkadës së fasadës perëndimore. Shiko detajin në vizatim.

#### **R.1.2.10 - Ulluk shkarkimi horizontal me llamarinë xingat 33 cm**

Sasia e metrave linearë që do të përdoren është përllogaritur a priori: një perimetër I plotë I objektit. Pas hapjes së objektit do të bëhet inspektim I mirëfilltë I sistemit ekzistues të kullimit të ujërave sepse objekti ka një sistem te kullimit të ujërave të shiut të futur brenda në muraturë. Nëse identifikohet vendndodhja dhe gjendja e këtij sistemi atëherëky do të vihet sërish në funksion. Në të kundërt do të përcaktohen pozicionet e shkarkimit të sistemit tëri, me ullukëshkarkimi llamarine xingat por që do të lyhen me të njëjtën ngjyrësi do të lyhet fasada e objektit në mënyrë që të mos e shqetësojnë vizualisht fasadën e objektit.

#### **R.1.2.11 - Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingat Ø 100 mm (\*5)**

Sasia e metrave linearë që do të përdoren është përllogaritur a priori: nga 2 ullukë shkarkimi vertikalë për faqet lindore dhe perëndimore si dhe nga një ulluk për faqet veriore dhe jugore. Kjo gjë do të përcaktohet saktësisht pas hapjes së objektit dhe do të veprohet njësoj si për rastin e ullukëve horizontalë. Pas vendosjes në objekt ullukët do të lyhen me bojën njësoj si fasada.



#### R.1.2.12 - Lyerje fasade me bojë hidromat

Në mbyllje të të gjitha punimeve realizohet procesi I lyerjes së fasadës. Në manual boja cilësohet si bojë hidroplastike por në objekt duhet të përdoret boja hidromat. Kjo lloj boje lejon aspirimin dhe shmang izolimin e lagështirës brenda në muraturë. Pas sondazheve të kryera në object është konkluduar që boja e lyerjes së re të ketë kodin HC-58 referuar katalogut të *“Benjamin Moore”*.



## **Punime prishje – R.2.1**

### **R.2.1.1 - Heqje pllakash majolike**

Një pjesë e muraturës është e veshur me pllaka majolike që arrijnë lartësi nga 70 cm deri në lartësinë 150 cm nga dyshemeja. Kjo veshje do të hiqet duke përdorur daltë e çekiç dhe duke u kujdesur që goditjet të mos shkojnë deri në sipërfaqen e muraturës për të mos e dëmtuar materialin e tullës.

Është përllogaritur që një m<sup>2</sup> sipërfaqe e veshur me pllakë mermeri të zhvishet nga një punëtor për jo më shumë se 1 orë.

### **R.2.1.2 - Heqje/cmontim tendash me konstruksion metalik**

Këta elementë janë të montuar në fasadën perëndimore, si tenda për të mbrojtur nga dielli vetratat e dyqaneve. Heqja e tyre do të bëhet me trapano për të zhvidhosur vidhat me të cilat është fiksuar në mur konstruksioni metalik I tyre.

Është përllogaritur që një tendë të hiqet brenda maksimumi 2 orësh.

### **R.2.1.3 - Heqje vetrata duralumin**

Vetratat e d/aluminit janë të vendosura në hyrjen e njësive tregëtare, në fasadën perëndimore. Këto janë të montuara në faqet e kolonave dhe harqeve të harkadës. Për këtë arsye duhet të tregohet kujdes gjatë çmontimit për të mos dëmtuar muraturën.

Çmontimi i vetratave të një hapësire drite midis dy kolonave është përllogaritur të realizohet në jo më shumë se 1 orë.

### **R.2.1.4 - Heqje qepenash**

Ky zë I referohet qepenit të njërës prej njësive tregëtare. Korniza e sistemit mekanik të tij është e montuar në faqet e kolonave dhe harqeve të harkadës. Për këtë arsye duhet të tregohet kujdes gjatë çmontimit për të mos dëmtuar muraturën.

Çmontimi i qepenit është përllogaritur që të mos zgjasë më shumë se 1 orë.

#### **R.2.1.5 - Heqje elemente metalike nga fasada e objektit (korrimano parapeti)**

Këta elementë janë të vendosur në objekt nga përdoruesit e objektit gjatë gjithë viteve të përdorimit. Për këtë arsye heqja e tyre duhet të bëhet me kujdes për të mos I dëmtuar më tej elementët e dekorit ose vetë muraturën.

Heqja e këtyre elementëve është përlogaritur të bëhet në një kohë shumë të shkurtër.

#### **R.2.1.6 - Çmontim kondicionerësh në fasadë**

Kondicionerët janë të vendosur në fasadë të objektit në mënyrë krejtësisht rastësore, pa u kujdesur aspak nëse ky veprim dëmton estetikisht objektin. Çmontimi I tyre do të bëhet gjatë fazës së punimeve të prishjes të zbatimit të projektit. Montimi I tyre do të bëhet në pjesën e pasme të objektit (në fasadën lindore të tij).

Çmontimi I një kondicioneri është përlogaritur të zgjasë jo më shumë se 1,5min.

#### **R.2.1.7 – Prishje muraturë tulle**

Ky zë pune I referohet mbylljes së harkut nr. 1 të harkadës në fasadën përendimore, I cili është I mbyllur me muraturë tulle. Gjatë prishjes së tij duhet treguar kujdes për të mos dëmtuar muraturën origjinale të objektit (harkun).

Prishja e 1m<sup>3</sup> muraturë tullë është përlogaritur të zgjasë jo më shumë se 6.2 orë duke përfshirë edhe largimin e inerteve dhe pastrimin e vendit.

#### **R.2.1.8 – Prishje suva ekzistuese**

Ky proces do të zhvillohet në të gjithë sipërfaqen fasadës përendimore të objektit. Heqja e suvasë do të bëhet me matrapik me daltë në formë spatule. Gotitjet e matrapikut nuk duhen bërë në drejtimin pingul me sipërfaqen e suvasë sepse nga goditja e fortë mund të dëmtojë muraturën e tullës nën suva. Prishja e një m<sup>2</sup> suva është përlogaritur të realizohet në jo më shumë se 1.5 orë duke marrë parasysh që suvaja është me llaç çimento dhe që duhet treguar kujdes gjatë prishjes për të mos dëmtuar muraturën.

#### **R.2.1.9 – Pastrim i materialit të drurit nga boja e mureve**

Ky proces do të realizohet në mënyrë mekanike, duke përdorur letër zmeril dhe duke zmeriluar lehtëzi sipërfaqen e drurit e cila ka mbetje të bojës së lyerjes së mureve, në mënyrë që të mos dëmtohet apo gërryhet vetë materiali I drurit. Për të arritur në zonat e imta të detajeve që mund të

ketë druri (thellime apo ngritje mbi sipërfaqen e përgjithshme) mund të përdoren furca teli të imta dhe të buta.

#### **R.2.1.10 – Heqje e pjesëve të dëmtuara të drurit (te harqet e vetratave)**

Ky proces do të realizohet pas inspektimit të imtësishëm për të përcaktuar kufirin e ndërhyrjes, I cili arrihet me anë të goditjeve të lehta me spatul metalike mbi sipërfaqen e drurit. Spatula e shonp lehtazi sipërfaqen ku materiali është I degraduar dhe has rezistencë në sipërfaqen me matërial të shëndetshëm.

Pasi të përcaktohet kufiri I ndërhyrjes, do të bëhet prerja me shumë kujdes e lëndëndës së degraduar, dhe më pas këto pjesë do të plotësohen me material të ri.

#### **R.2.1.11– Çmontim i çatisë me tjegulla vendi**

Ky proces duhet të realizohet me kujdes që të mos dëmtohen tjegullat; të ruhen sa më shumë prej tyre për t'u ripërdorur për mbulimin e çatisë në përfundim të punimeve. Do të bëhet çmontimi I të gjithë shtresës së tjegullave; tjegullat e përzgjedhura për ripërdorim do të magazinohen me kujdes dhe para ripërdorimit do të pastrohen me furcë teli dhe do të lahen.

Pas çmontimit të tjegullave do të bëhet çmontimi i listelave të drurit, mbi të cilat janë aktualisht të vendosura tjegullat. Do të bëhet inspektimi I cilësisë së materialit drusor ekzistues të binarëve dhe tratëve tëçatisë. Elementët, materaili I të cilëve është e padëmtuara do të qëndrojnë sërish nëçati ndërsa elementët e dëmtuar (deformuar apo kalbur) do të magazinohen dhe do të zëvendësohen. Elementët që do të zëvendësohen do të bëhen saktësisht me material, dimensione dhe teknikën e elementëve ekzistues.

Çmontimi I një metri katror mbulesë çatie me tjegulla marsejeze është përlllogaritur të zgjasë jo më shumë se 6.5 orë, duke marrë parasysh faktin që është e pa njohur gjendja e konservimit të kosntrukcionit të çatisë.

*Shënim 1 – do të bëhet heqja e shtresës së tjegullave për të inspektuar shtresën hidrizoluese, nëse ka ose jo dhe në rast se ka në çfarë gjendje mund te jetë.*

#### **R.2.1.12 – Heqje oxhakësh metalikë e plastikë në çati në pjesën e përparme**

Heqja e oxhakëve do të bëhet manualisht dhe I gjithë procesi është përlllogaritur të zgjasë jo më shumë se 1.5 min.

### **Punime ndërtimi – R.2.2**

### **R.2.2.1 - Ndërtim çati vendi e zokonshme HD-8m mbuluar me tjegulla vendi (30% e sipërfaqes totale e çatisë)**

Pas procesit të hapjes së objektit do të vlerësohet gjendja faktike e elementëve që do të shërbejnë për t'u ripërdorur dhe elementët që do të zëvendësohen. Elementët që nuk paraqesin anomali (deformim, kalbje apo dëmtim nga insektet) do të ripërdoren. Elementët e tjerë që nuk do të përdoren do të ruhen në magazinë për ti pasur si referencë për prodhimin e materialit tëri. Elementët drusorë që do të zëvendësohen duhet të jenë dru pishe, minimalisht 5 vjet i stazhionuar në mënyrë natyrale dhe i trajtuar me dy duar vaj lini dhe insekticid. Elementët që do të zëvendësohen duhet të bëhen me të dhënat saktësisht si elementët ekzistues. (lloj druri, dimensione dhe teknikë).

Nga vlerësimi paraprak I gjendjes së konservimit të konstruksionit tëçatisëështë gjykuar që rreth 30% e materialit konstruktiv ka nevojë të zëvendësohet, pjesa tjetër do të ripërdoret. Konkretisht kjo gjë do të vlerësohet gjatë fazës së hapjes së objektit.

Çatia aktuale nuk ka shtresën e dyshemesë së drurit si dhe shtresat termo dhe hidro izoluese. Çatia e re parashikon ndërtimin e saj me të gjithë elementët konstruktivë dhe izolues të nevojshëm, por shtresa e dyshemesë sëçatisë si dhe hidroizolimi do të trajtohen në zërat e më poshtëm të specifikimeve teknike duke qenë se këta dy elementë mungojnë tërësisht nëçati dhe do të bëhen të reja në 100 të sipërfaqes sëçatisë.

### **R.2.2.2 - Ndërtim dysheme dërrase për çati (sipërfaqja totale - kjo shtresë mungon aktualisht)**

Çatia ekzistuese e objektit nuk ka shtresë dysheme dërrase dhe tjegullat vendosen mbi listela druri të kapura drejtpërdrejtë mbi mahi. Projekti I restaurimit parashikon edhe vendosjen e kësaj shtrese.

Dyshemeja e dërrasës sëçatisë, 2.5cm e trashë, do të realizohet me material dru pishe të stazhionuar minimalisht 5 vjet në mënyrë natyrale dhe e trajtuar me vaj lini dhe insekticid.

### **R.2.2.3 - Hidroizolim me emulsion bitumi dhe dy shtresa katrama**

Ky zë është element krejtësisht i ri në çatinë e objektit. Aktualisht çatia nuk ka një shtresë hidroizoluese. Hidroizolimi do të bëhet duke I mbivendosur shtresat (rreth 12-15 cm). Në pjesën fundore tëçatisë, ku objekti takohet me objektin nr. 1, shtresa hidroizoluese do të ngrihet në murin vertical (të objektit nr. 1) me minimum 15 cm, në zonën ku do të vendoset më vonë impluvi I llamarinës, në mënyrë që të arrihet izolimi I plotë nga lagështira.

#### **R.2.2.4 - Qeramosje çatie me tjegulla vendi (zbulim - mbulim çatie, plotësime me tjegulla)**

Çati aktuale është e mbuluar me tjegulla vendi, të cilat do të hiqen për të realizuar rehabilitimin e çatisë, në brendësi të saj dhe do të rivendosen sërish. Por jot ë gjitha tjegullat që do të hiqen, do të mund të ripërdoren. Gjatë procesit të zbulimit të çatisë do të bëhet edhe seleksionimi I tjegullave. Tjegullat që do të ripërdoren, do të magazinohen me kujdes dhe para se të rivendosen do të pastrohen me furçë teli dhe do të lahen me ujë të bollshëm. Në preventive është vendosur e gjithë sipërfaqja e çatisë sepse procesi I zbulimit dhe I rimbulimit do të bëhet në të gjithë sipërfaqen porn ëçmim është llogaritur një nr. Më I vogël tjegullash për metër katror duke qenë se vetëm një pjesë e tjegullave do të zëvendësohen/blihen të reja, konkretisht rreth 30% e sipërfaqes së çatisë do të ketë nevojë për zëvendësim tjegullash.

#### **R.2.2.5 - Restaurim strehe çatie**

Streha e çatisë së objektit në përgjithësi është në gjendje të mirë, por në fasadën perëndimore, në zonën ku objekti nr. 2 bashkëngjitet me objektin nr. 1, për shkak të mos izolimit të mirë të lagështirës në këtë zonë, materiali drusor është degraduar. Kjo është zona që do të restaurohet streha e çatisë. Përpara së gjithash do të bëhet inspektimi I imtësishëm I lëndës drusore për të përcaktuar qartë kufirin e ndërhyrjes – materialit që do të hiqet dhe atij që do të qëndrojë e trajtohet. Inspektimi bëhet me anë të goditjeve të lehta me spatul metalike mbi sipërfaqen e drurit. Spatula e shonp lehtësisht materialin e degraduar të drurit dhe has rezistencë në materialin e shëndetshëm.

Materiali I shëndetshëm do të trajtohet me vaj lini dhe insekticid, kurse ai që do të zëvendësohet duhet të bëhet saktësisht me të njëjtët parametra si modeli i strehës ekzistuese (material, formë, dimension dhe teknikë). Këta parametra do të merren në vend, gjatë fazës së zbulimit të çatisë.

Në analizën e çmimit është llogaritur vetëm lënda e drurit (në seksionin e materialeve) sepse hidroizolimi dhe tjegullat janë llogaritur në zëra të vecantë.

#### **R.2.2.6 – Furnizim / vendosje impluve llamarine zingato**

Në mënyrë që të arrihet izolimi sa më I plotë I çatisë ndaj lagështirës, është e domosdoshme vendosja e impluvit të llamarinës së zonën ku objekti nr.2 bashkëngjitet me objektin nr.1. Impluvet do të jenë material llamarinë zingato 0.8mm të trashë dhe do të kapen në murin vertikal (të objektit nr. 1) rreth 20cm dhe do të zgjaten horizontalisht rreth 25-30cm nëçatinë e objektit nr.2.

### **R.2.2.7 - Suvatim muri i jashtëm me llaç gëlqere 1:3**

Në objekt aktualisht suvaja ka edhe përmbajtje çimentoje. Pas përpjekjes së pasukseshme për të bërë analiza laboratorike për të gjetur raportin e përzjerjes së përbërësve të llaçit ekzistues, gjykojme që suvaja e re të jetë vetëm me llaç gëlqere në raportin 1:3 ku gëlqerja të jetë e stazhionuar minimalisht 1 vit. Ky lloj llaçi është miqësor ndaj materialit të muraturës, është më i butë së materiali dhe lejon aspirimin si dhe largimin e lagështirës. Duke përdorur këtë lloj llaçi jemi të sigurtë muratura nuk do të ketë dëmtime afatgjate ose afatshkurtra që vijnë për shkak të suvasë.

### **R.2.2.8 – Ndërtim mur me tulla të plota me lartësi deri në 3m me llaç të përzjerë M25**

Ky zë përfshin ringritjen e parapeteve të dritareve në harqet e harkadave (aty ku mungon). Parapeti do të ngrihet deri në lartësinë rreth 65 cm (si modeli ekzistues). Do të ndërtohet me tulla qeramike të përmasave 25x12x8 cm si dhe lidhja e tyre do të bëhet me llaç të përzjerë. Suvatimi I tyre do të bëhet kur të bëhet edhe suvatimi I të gjithë fasadës, me llaç gëlqere 1:3.

### **R.2.2.9 – Mbylljeve e harqeve të harkadës me material druri.**

Këto punime i referohen pjesës së sipërme të harkut, nga niveli fundor i derës dhe vetratës deri në kulmin e harkut. Aktualisht nga shtatë harqe të harkadës vetëm dy ruajnë këtë model I cili është dhe modeli më I vjetër I ardhur deri sot I trajtimit të fasadës. Për këtë arsye edhe pjesa tjetër e harqeve, vetrata e të cilëve është tjetërsuar tërësisht, do të mbyllin po me material druri.

Fillimisht do të bëhet inspektimi I imtësishëm I gjendjes së konservimit të materialit të harqet që ruajnë këtë model duke përcaktuar këtu kufirin e ndërhyrjes, materialin që do të ruhet dhe atë të degraduar. Inspektimi do të bëhet me anë të goditjeve të lehta me spatul metalike mbi sipërfaqene drurit. Spatula shpon leghtësisht materialin e degraduar dhe has rezistencë në materialin e shëndetshëm të drurit.

Pas përcaktimit të kufirit të ndërhyrjes, bëhet trajtimi me vaj lini dhe insekticid I materialit që do të ruhet si dhe do të bëhet zëvendësimi I lëndës së degraduar (ose të munguar). Materiali I ri do të jetë dru pishe I stazhionuar, I trajtuar me vaj lini dhe insekticid, dhe do të realizohet rigorozisht sipasa dimensioneve, modelit dhe mënyrës së vendosjes në vepër si ai ekzistues. Ky informacion mund të merret në objekt vetëm gjatë fazës së zbatimit, gjatë punimeve të prishjes.

### **R.2.2.10 - FV dritare druri pishe të stazhionuar**

Ky zë I referohet furnizimit dhe vendosjes në vepër të pjesës së palëvizëshme të vetratave të drurit në fasadën perëndimore. Të gjitha kasat e dritareve duhet të realizohen me dru pishe të stazhionuar në



mënyrë natyrale për një periudhë minimalisht 5 vjeçare dhe të jetë trajtuar me dy duar vaj lini përpara se të montohet në vepër.

Karakteristikat e drurit të pishës duhet të jenë si më poshtë:

- \* Lagështira jo më e lartë se 7%
- \* Peshë volumore rreth 450-540kg/m<sup>3</sup>
- \* Kufiri I rezistencës në tërheqje rreth 130MPa.

Kujdes I veçantë duhet të tregohet gjatë vendosjes së tyre në vepër, për përuthjen sa më të mirë të me hapësirat përkatëse.

#### **R.2.2.9 - FV dyer druri pishë të stazhionuar**

Ky zë I referohet furnizimit dhe vendosjes në vepër të dyerve të njësive tregëtare, në fasadën perëndimore. Të gjitha kasat dhe kanatat e dyerve duhet të realizohen me dru pishë të stazhionuar në mënyrë natyrale për një periudhë minimalisht 5 vjeçare dhe të jetë trajtuar me dy duar vaj lini përpara se të montohet në vepër. Dyert hyrjeve të njësive tregëtare kanë të njëjtin konfiguracion njësoj si dritaret prandaj është përdorur si referencë edhe çmimi I zërit R.2.2.3.

Karakteristikat e drurit të pishës duhet të jenë si më poshtë:

- \* Lagështira jo më e lartë se 7%
- \* Peshë volumore rreth 450-540kg/m<sup>3</sup>
- \* Kufiri I rezistencës në tërheqje rreth 130MPa.

Kujdes I veçantë duhet të tregohet gjatë vendosjes së tyre në vepër, për përuthjen sa më të mirë të me hapësirat përkatëse.

#### **R.2.2.10 - Lyerje fasade me bojë hidromat**

Në mbyllje të të gjitha punimeve realizohet procesi I lyerjes së fasadës. Në manual boja cilësohet si bojë hidroplastike por në objekt duhet të përdoret boja hidromat. Kjo lloj boje lejon aspirimin dhe shmang izolimin e lagështirës brenda në muraturë. Fasada perëndimore nuk është fasada origjinale, madje edhe në fasadën që ka ardhur deri sot, nuk ruhen as gjurmë të suvasë së vitit 67-70 (periudha e zgjerimit të objektit)pasi zotëruesit ose përdoruesit e njësive tregëtare kanë bërë ndërhyrje me karakter rehabilitues, ndër të cilat edhe risuvatim dhe lyerje të fasadave të njësive përkatëse. Për këtë arsye, realizimi I sondazheve për evidentimin e ngjyrës fillestare të fasadës është I pa mundur.

Në këto kushte, për të rritur sa më shumë uniformitetit e pamjes së fasadave të monumenteve të kulturës do të përdorim të njëjtën ngjyrë edhe për lyerjen e muraturës së këtij objekti njësoj si për objektin nr.1 – konkretisht me kod HC-58 referuar katalogeve universal për përcaktimin e ngjyrave.

## **Punime prishje – R.3.1**

### **R.3.1.1 - Heqje/cmontim tendash me konstruksion metalik**

Këta elementë janë të montuar në fasadën perëndimore, si tenda për të mbrojtur nga dielli vetratat e dyqaneve. Heqja e tyre do të bëhet me trapano për të zhvidhosur vidhat me të cilat është fiksuar në mur konstruksioni metalik I tyre.

Është përllogaritur që të gjitha tendat (rreth 20m<sup>2</sup>) të hiqen brenda maksimumi 2.5 orësh.

### **R.3.1.2 - Çmontim kondicionerësh në fasadë**

Janë dy kondicionerë të montuar në fasadën e katit përdhe të objektit.

Çmontimi I një kondicioneri është përllogaritur të zgjasë jo më shumë se 2 orë.

### **R.3.1.3 – Prishje suva ekzistuese**

Ky process do të zhvillohet pjesërisht në fasadën kryesore të objektit pasi vetëm një pjesë e suvasë është e degraduar dhe mund të këtë nevojë të ribëhet. Heqja e suvasë do të bëhet me matrapik me daltë në formë spatule. Gotitjet e matrapikut nuk duhen bërë në drejtimin pingul me sipërfaqen e suvasë sepse nga goditja e fortë mund të dëmtojë muraturën e tullës nën suva.

Prishja e një m<sup>2</sup> suva është përllogaritur të realizohet në jo më shumë se 7-10min.

### **R.3.1.4 - Heqje mareriali të degraduar në dekore dhe parapete (pastrim mekanik me spatul dhe fuqë teli)**

Ky proces do të realizohet mekanikisht fillimisht duke goditur lehtësisht me spatul mbi pjesën e degraduar të dekoreve për të hequr materialin e degraduar por njëkohëshit edhe për të identifikuar kufirin deri ku ka material të degraduar. Më pas pas bëhet pastrimi me fuqë të butë teli për të hequr edhe pjesët më të imëta të materialit të degraduar.

Ky proces është përllogaritur të zgjasë jo më shumë se 2 orë për ml material të degraduar.

### **R.3.1.5 - Pastrim I ndryshkut nga kangjellat metalike, në mënyrë mekanike**

Ky process do të realizohet në kandgjellat e krahut të majtë të objektit, krahu që ruan kangjellat metalike. Do të realizohet me furçë teli të butë dhe me letër zmerile.

## **Punime ndërtimi – R.3.2**

### **R.3.2.1 - Suvatim muri I jashtëm me llaç gëlqere 1:3**

Në objekt aktualisht suvaja ka edhe përmbajtje çimentoje. Pas përpjekjes së pasukseshme për të bërë analiza laboratorike për të gjetur raportin e përzjerjes së përbërësve të llaçit ekzistues, gjykojme që suvaja e re të jetë vetem me llaç gëlqere në raportin 1:3 ku gëlqerja të jetë e stazhionuar minimalisht 1 vit. Ky lloj llaçi është miqësor ndaj materialit të muraturës, është më i butë së materiali dhe lejon aspirimin si dhe largimin e lagështirës. Duke përdorur këtë lloj llaçi jemi të sigurtë muratura nuk do të ketë dëmtime afatgjate ose afatshkurtra që vijnë për shkak të suvasë.

### **R.3.2.2 - Plotësim dekori me llaç çimento**

Fillimisht bëhet përgatitja e kallëpëve për çdo profil të veçantë dekori, nëpërmjet të cilëve më pas do të bëhet e mundur plotësimi në vend I elementëve të degraduar. Për plotësimin e elementëve të dekoreve do të përdoret llaç gëlqere dhe çimento. Në rastin e dekoreve, përdorimi I çimentos është I përshtatshëm duke qenë se elementët e dekorit janë më të ekspozuar se suvaja në përgjithësi si ndaj dëmtimeve që vijnë për shkaqe natyrore (agjentët atmosferikë) si ndaj dëmtimeve mekanike. Raporti I çimentos, gëlqeres dhe rërës nuk duhet të jetë më I dobët se respektivisht 1:3:12 sepse ndryshe gëlqerja do të ulë rezistencën e llaçit ndaj ngricave. Megjithatë raporti nuk duhet të jetë as më I fortë se 1:2:9 sepse kjo është një përbërje e përshtatëshme për objektet e trashëgimisë.

### **R.3.2.3 - Lyerje fasade me bojë hidromat**

Në mbyllje të të gjitha punimeve realizohet procesi I lyerjes së fasadës. Në manual boja cilësohet si bojë hidroplastike por në objekt duhet të përdoret boja hidromat. Kjo lloj boje lejon aspirimin dhe shmang izolimin e lagështirës brenda në muraturë. Nuk u bënë sondazhe përpër të përcaktuar ngjyrën e lyerjes aktualisht por për të rritur sa më shumë uniformitetit e pamjes së fasadave të monumenteve të kulturës do të përdorim të njëjtën ngjyrë edhe për lyerjen e muraturës së këtij objekti njësoj si për objektin nr.1 – konkretisht me kod HC-58 referuar katalogeve universal për përcaktimin e ngjyrave.

### **R.3.2.4 – Zëvendësim I kangjellave metalike**

Ky zë I referohet zëvendësimit të kangjellave metalike të ballkonit të krahut të djathtë të objektit, pasi këtu janë tjetërsuar kangjellat. Kangjellat e reja duhet të respektojnë rigorozisht modelin,

materialin, përmasat dhe mënyrën e vendosjes në vepër, të kangjellave të ballkonit në krahun e majtë të objektit. Fatmirësisht kjo anë e objektit ruan ende kangjellat origjinale të tij.

#### **R.3.2.5 - Boje vaji sipërfaqe metalike te korimanove**

Ky proces do të realizohet mbi sipërfaqet metalike të cilat janë pastruar nga ndryshku me furçë teli të butë dhe para se të aplikohet boja duhet që kangjellat të trajtohen me lëndë antindryshk dhe më pas të aplikohet boja e vajit. Ngjyra e bojës do të përcaktohet në objekt pasi të provohet të kryen sondazhe për të nxjerrë ngjyrën origjinale të kangjellave.



## **Punime prishje – R.4.1**

### **R.4.1.1 - Heqje pllakash majolike**

Një pjesë e muraturës është e veshur me pllaka majolike që arrijnë lartësi nga 70 cm deri në lartësinë 150 cm nga dyshemeja. Kjo veshje do të hiqet duke përdorur daltë e çekiç dhe duke u kujdesur që goditjet të mos shkojnë deri në sipërfaqen e muraturës për të mos e dëmtuar materialin e tullës. Është përllogaritur që një m<sup>2</sup> sipërfaqe e veshur me pllakë mermeri të zhvishet nga një punëtor për jo më shumë se 1 orë.

### **R.4.1.2 - Heqje/cmontim tendash me konstruksion metalik**

Këta elementë janë të montuar në fasadën perëndimore, si tenda për të mbrojtur nga dielli vetratat e dyqaneve. Heqja e tyre do të bëhet me trapano për të zhvidhosur vidhat me të cilat është fiksuar në mur konstruksioni metalik I tyre.

Është përllogaritur që tendë të hiqetbrenda maksimumi 2 orësh.

### **R.4.1.3 - Heqje/cmontim reklamash me konstruksion metalik**

Janë reklama të thjeshta, të pa ndriçuara, me dhe pa lidhje elektrike. Për çmontimin e reklamave do të veprohet njësoj si për çmontimin e tendave; do të zhvidhosen me trapano vidhat e fiksimit të konstruksionit metalik.

Është përllogaritur që 1 reklamë të çmontohetbrenda maksimumi 1 ore.

### **R.4.1.4 - Heqje vetrata duralumin**

Vetratat e d/aluminit janë të vendosura në hyrjen e njërive tregëtare, në fasadën jugore.

### **R.4.1.5 - Heqje qepenash**

Ky zë I referohet qepenave që janë vendosur në hyrjet e njërive tregëtare të objektit 4.

Çmontimi i qepenit është përllogaritur që të mos zgjasë më shumë se 1 orë.

#### **R.4.1.6 – Prishje suva ekzistuese**

Ky process do të zhvillohet në të gjithë sipërfaqen e muraturës së objektit 4. Heqja e suvasë do të bëhet me matrapik me daltë në formë spatule. Gotitjet e matrapikut nuk duhen bërë në drejtimin pingul me sipërfaqen e suvasë sepse nga goditja e fortë mund të dëmtojë muraturën e tullës nën suva. Prishja e një m<sup>2</sup> suva është përlogaritur të realizohet në jo më shumë se 1.5 orë.

#### **R.4.1.7 – Heqje oxhakësh metalikë e plastikë në pjesën e përparme të tarracës së objektit**

Ky proces I referohet heqjes së oxhakëve dhe zëvendësimit të tyre me oxhakë më të vegjël në mënyrë që të mos shihen nga kalimtarët në zonë. Pra duhet të jenë më të shkurtër se lartësia e parapetit.

### **Punime ndërtimi – R.2.2**

#### **R.4.2.1 - Ndërtim mur me tulla të plota në lartësi deri 3m me llaç përzier M 25**

Ky zë I referohet plotësimit të parapetit në pjesën lindore të objektit. Parapet do të ndërtohet me tulla të plota; gjerësia e tij do të jetë 12 cm; tullat do të lidhen me llaç të përzier M25.

#### **R.4.2.2 - Suvatim muri I jashtëm me llaç gëlqere 1:3**

Ky zë do të aplikohet në të gjithë sipërfaqen e muraturës. Suvaja e re duhet të jetë vetëm me llaç gëlqere në raportin 1:3 ku gëlqerja të jetë e stazhionuar minimalisht 1 vit. Ky lloj llaçi është miqësor ndaj materialit të muraturës, është më i butë së materiali dhe lejon aspirimin si dhe largimin e lagështirës.

#### **R.4.2.3 - F V dyer d/alumini (plastike) me dopio xham**

Ky zë I referohet furnizmit dhe vendosjes në vepër të pjesës së palëvizëshme të vetrinave në çdo njësi tregëtare në të gjithë fasadën (jugore dhe atë lindore) të objektit 4.

#### **R.4.2.4 - F V vetrate d/alumini (plastike) me dopio xham**

Ky zë I referohet furnizmit dhe vendosjes në vepër të dyerve të vetrinave në çdo njësi tregëtare në të gjithë fasadën (jugore dhe atë lindore) të objektit 4.

#### **R.4.2.5 - Lyerje fasade me bojë hidromat dhe ngjyre sipas kodit të përcaktuar.**

Në mbyllje të të gjitha punimeve realizohet procesi I lyerjes së fasadës. Në manual boja cilësohet si bojë hidroplastike por në objekt duhet të përdoret boja hidromat. Kjo lloj boje lejon aspirimin dhe shmang izolimin e lagështirës brenda në muraturë. Për të rritur sa më shumë uniformitetit e pamjes së fasadave të objekteve rreth sheshit “Avni Rustemi” do të përdorim të njëjtën ngjyrë edhe për lyerjen e muraturës së këtij objekti njësoj si për objektin nr.1 – konkretisht me kod HC-58 referuar katalogeve universale për përcaktimin e ngjyrave.

